

## STATUTI

### i Shoqërisë “ AISM “

#### Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

#### Kreu I

#### Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

#### Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Mbeshtetur ne Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, sot më 15-06-2021, krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “AISM “

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

**Z. ANDREA SALILLARI**, i biri i Niko-s dhe i Marije-s, datëlindja 21-11-1973, shtetas shqiptar, disponues karte identiteti nr. personal H31121013N.

**Z. ILIR MEÇE**, i biri i Ylli-t dhe i Vjollca-s, datëlindja 01-07-1971, shtetas shqiptar, disponues karte identiteti Nr. personal H10701200A.

#### Neni 2: Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

- Financimin, projektimin, ndertimin, venien ne pune, operimin, administrimin, mirembajtjen e Hidrocentraleve.
- Ofrimi i shërbimit të oponencave të projekteve të fizibilitetit dhe zbatimit të hidrocentraleve.
- Ofrimi tek institucionet financiare/kredihënëse, i shërbimit të konsulencave si dhe oponencave të projekteve të para-fizibilitetit, fizibilitetit dhe zbatimit, si dhe aplikimit në tërësi, të njësive gjeneruese.
- Ofrimi i shërbimit për llogaritjet hidroenergjetike të parafizibilitetit si dhe fizibilitetit të hidrocentraleve.
- Ofrimi i shërbimeve për studimin e rezervave të energjisë hidrike të lumenjve të Shqipërisë.
- Ofrimi i shërbimit të studim-projektimit të njësive të ndryshme të prodhimit të energjisë elektrike, përfshirë dhe pa u limituar në hidrocentrale, parqe eolike, panele diellore, biomasë, biodiezel, të projektit të zbatimit, ndjekjen përkatëse të punimeve si dhe mirëmbajtjen e njësive gjeneruese. Pjesëmarrja në kuota (aksione) në njësi të ndryshme të prodhimit të energjisë elektrike, përfshirë dhe pa u limituar në hidrocentrale, parqe eolike, panele diellore, biomasë, biodiezel etj;
- Ofrimi i shërbimit të studim-projektimit të linjave të tensionit të lartë, mesëm dhe të ulët, të projektit të zbatimit si dhe ndjekja përkatëse e punimeve.
- Ofrimi i shërbimit të studim-projektimit të kabinave të ndryshme elektrike të linjave të tensionit të lartë, mesëm dhe të ulët, të projektit të zbatimit si dhe ndjekja përkatëse e punimeve.
- Ndërtimi i njësive të ndryshme të prodhimit të energjisë elektrike, përfshirë dhe pa u limituar në hidrocentrale, parqe eolike, panele diellore, biomasë, biodiesel. Ndërtimi i

kabinave të ndryshme elektrike të linjave të tensionit të lartë, mesëm dhe të ulët, ndërtimi i veprave civile dhe industriale.

- Tregtia e energjisë elektrike, përfshirë dhe pa u limituar në, shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar të aplikueshëm. Tregtia e energjisë elektrike mund të zhvillohet në territorin e Shqipërisë ose jashtë saj, në përputhje me nevojat e shoqërisë. Pjesëmarrja në ankandet për alokimin e të drejtave të transmetimit (PTR-s), siç zhvillohen në Shqipëri ose jashtë saj. Pjesëmarrja në bursat e energjisë të themeluara në rajon si dhe bursën përkatëse shqiptare (kur dhe në rast sethemelohet). Furnizimi me energji elektrike i të gjithë konsumatorëve fundorë në Shqipëri, përfshirë konsumatorët e lidhur në tensionin e ulët, të mesëm dhe të lartë.
- Themelimin e grupit të tij balancues ose pjesëmarrja në grupin balancues të shoqërive të tjera. Marrjen hua për investime si dhe financim asetesh/veprave me karakter energjetik. Shoqëria ka si objekt veprimtarie kryerjen e të gjitha veprimtarive që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të ligjit shqiptar, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë si dhe çdo formë e aktiviteteve ligjore dhe komerciale që konsiderohet fitimprurëse për shoqërinë. Shoqëria mund të ndryshojë si dhe të shtojë objektin e veprimtarisë së saj, vetëm pas miratimit të Asamblesë së Përgjithshme.

### Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat duke filluar që nga regjistrimi i saj në QKB.

### Neni 4: Selia, email:

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : Çiflig, Korçë, Zona kadastrale 1403, Pasuria Nr. 175/136, Km i parë , Rruga Nacionale Korçë- Pogradec.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hap zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale brenda Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

## Kreu II

### Kapitali i Themeltar

#### Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **10.000 Lekë ( dhjetë mijë lekë)** përfaqëson dy aksione. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet dhe perbehet nga Ortakët themelues :

- 1- Ortaku Themelues : **ANDREA SALILLARI** zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 5.000 lekë që përbën **50 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2- Ortaku Themelues : **ILIR MEÇE** zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 5.000 lekë që përbën **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme.

Ortakët themelues përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### Neni 6 Transferimi i kuotave



Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim me akt noterial.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **Neni 7 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

(1) Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

(2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

### **Kreu III**

#### **Asambleja e Përgjithshme**

#### **Neni 8**

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakët themelues .

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët themelues regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Administratorët thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas nenit 84 të Ligjit. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë të dërguar me postë ose postë elektronike (*email*) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë ose mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e duhet të dërgohet jo më vonë se shtatë Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen.

Kur Asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikes 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavaresisht parregullsisë.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88

të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

## Neni 9

Asambleja vendos për çështje si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- m) të bleje, shesë, këmbje pasuri të patundshme të shoqërisë;
- n) për shpërndarjen e fitimit.

Te zbatoje kriteret e caktuara nga ligji në fuqi për punetoret dhe nepunesit që punesohen në shoqëri.

## Kreu IV

### Administrimi

#### Neni 10 Emërimi i Administratorëve

Asambleja e Përgjithshme sipas përcaktimeve të bera në ligj emeron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare i cili mund të jetë ose jo ortak i shoqërisë.

**Shoqëria në krijimin e saj do të ketë një administrator të Vetem i cili është Z. ANDREA SALILLARI Administratori përcaktohet për një afat kohor prej 5 vjetësh.**

#### Neni 11 Kompetencat e Administratorëve

Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtroj të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 81 të Ligjit.

Administratori i shoqërisë ka të gjitha kompetencat që të veprojë në emer dhe për llogari të shoqërisë në mardhenie me të tretet.

Administratori dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratori nuk mund të delegojnë detyrimet e tij ligjore.

**Administratori ka të drejtë e detyrohet të:**

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhohet shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorëve caktohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit.

## **Kreu V**

### **Bilanci, Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

#### **Neni 12 Bilanci**

Bilanci i shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar nga administratori miratohen nga asambleja. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore behet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

#### **Neni 13 Dividendët**



Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

#### **Neni 14 Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

#### **Kreu VI**

#### **Prishja dhe njoftimet**

#### **Neni 15 Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqeri në likuidim e sipër ".

#### **Neni 16 Njoftimet**

Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim te cilat do te dergohen me poste ose nëpërmjet komunikimit elektronik dhe sipas specifikimeve të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin dhe sipas përcaktimeve ne ligj.

Te gjitha mosmarreveshje qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit do te paraqiten per zgjidhje Gjykatës kompetente Shqiptare

**Ky statut eshte hartuar ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe.**

**Ortakët Themelues**

**ANDREA SALILLARI**

**ILIR MEÇE**